



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 4657/Prot.
1

Tiranë, më 22.06 2021

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1700, datë 21.05.2014.

SHOQËRISË “PROGRESI-L” SH.PK
Prrenjas, Librazhd, Qarku Elbasan

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “PROGRESI-L” sh.p.k, e cila është zotëruese e Lejes Minerare të shfrytëzimit Nr.1700, datë 21.05.2014, për mineralin Gëlqeror i mermerizuar, në objektin “Babje”, Librazhd, Qarku Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.2195, datë 02.06.2021, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.4657, Prot, datë 04.06.2021, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1700, datë 21.05.2014, për mineralin Gëlqeror i mermerizuar, në objektin “Babje”, Librazhd, Qarku Elbasan, sepse në objekt nuk ka filluar aktiviteti minerar qe nga marrja e lejes minerare te shfrytëzimit deri me sot.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen minerare të shfrytëzimit Nr.1700, datë 21.05.2014, për mineralin Gëlqeror i mermerizuar, në objektin “Babje”, Librazhd, Qarku Elbasan.**

, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit **Nr.1700, datë 21.05.2014, për mineralin Gëlqeror i mermerizuar, në objektin “Babje”, Librazhd, Qarku Elbasan..**

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

